TOP CHANNEL sh.a

Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-31

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

Per Drejtimin e Shoqerise Top Channel Sha

Opinioni me rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Top Channel Sha, te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2021, pasqyren e performances dhe te ardhurave te tjera gjitheperfshirese, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e flukseve te parase per vitin qe mbyllet ne kete date si dhe shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare, perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tone, pervec efektit te çeshtjes se pershkruar ne seksionin e Bazes per Opinionin me Rezerve te raportit tone, pasqyrat financiare bashkelidhur paraqesin drejte, ne te gjitha aspektet materiale pozicionin financiar te Shoqerise me 31 Dhjetor 2021, performancen financiare e flukset e parase per vitin qe mbyllet ne kete date, ne pajtim me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza per Opinionin me Rezerve

Ne pasqyrat financiare te Shoqerise me 31 Dhjetor 2021 "te drejtat e arketueshme" pasqyrohen ne shumen 572,973,047 Lek (31 Dhjetor 2020: 754,225,307 Lek) dhe "llogari te pagueshme tregtare" pasqyrohen ne shumen 374,885,713 Lek (31 Dhjetor 2020: 701,853,643 Lek). Nga nje perzgjedhje qe ne kemi bere nga "te drejtat e arketueshme" dhe nga "llogari te pagueshme tregtare", ne kemi identifikuar kliente te paarketuar dhe furnitore te papaguar per me shume se 365 dite me 31 dhjetor 2021 dhe me 31 dhjetor 2020. Ne nuk kemi arritur te merrnim siguri me procedura te tjera auditimi per keto "te drejtat e arketueshme" dhe "llogari te pagueshme tregtare", ne daten 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020. Gjithashtu Shoqeria nuk ka krijuar nje model zhvleresimi ne perputhje me kerkesat e SNRF 9 per "te drejtat e arketueshme". Per rrjedhoje ne nuk jemi ne gjendje te sigurohemi ne lidhje me saktesine e te drejtave te arketueshme me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020. Ne opinionin tone Shoqeria duhet te krijoje nje model zhvleresimi ne perputhje me kerkesat e SNRF 9, si edhe nje fond per zhvleresimin e ketyre shumave qe te jete ne perputhje me kete model zhvleresimi. Rrjedhimisht, per shkak te sa me sipër, ne e kishim te pamundur te percaktonim nese ndonje korrigjim do te mund te ishte i nevojshem "te drejtat e arketueshme" dhe "llogari te pagueshme tregtare" si edhe ne rezultatin e vitit.

Ne kryem auditimin tone neperputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNAs). Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve janë pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me Kodin e Etikes per Profesionistet Kontabel te Bordit te Standardeve Nderkombetare te Etikes per Profesionistet Kontabel (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikes te Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar ne Shqiperi (Kodi i IEKA) qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi, dhe kemi përmbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me këto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone.

Nexia AL

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

Informacioni tjeter

Drejtimi eshte pergjegjes per informacionin tjeter. Informacioni tjeter perfshin Raportin Vjetor, por nuk perfshin pasqyrat financiare dhe raportin tone te auditimit mbi to.

Raporti yne mbi keto pasqyra financiare nuk mbulon dhe informacionin tjeter dhe ne nuk shprehim opionion ose ndonje lloj tjeter konkluzioni sigurie mbi to.

Ne lidhje me auditimin tone te pasqyrave financiare, pergjegjesia jone eshte te lexojme informacionin tjeter dhe, gjate ketij procesi, te konsiderojme nese informacioni tjeter eshte ne menyre materiale jo konsistent me pasqyrat financiare ose me njohurite e perfituara gjate auditimit ose nese ne dukje eshte ne menyre materiale i gabuar.

Nese, bazuar ne punen qe ne kemi kryer, ne arrijme ne perfundimin se ka gabime material ne informacionin tjeter, atehere ne duhet ta raportojme kete fakt. Ne daten e leshimit te ketij raporti, Shoqeria akoma nuk e ka publikuar informacionin tjeter. Ne nuk kemi asgje per te raportuar ne lidhje me te.

Pergjegjesite e Drejtimit dhe te Personave te Ngarkuar me Qeverisjen ne lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare ne perputhje me SNRFdhe per ato kontrolle te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk përmbajnë anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit apo gabimit.

Ne pergatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi eshte pergjegjes per vleresimin e aftesise se Shoqerise per te vazhduar ne kushtet e vijimesise se biznesit, zbulimin, sipas rastit, te çeshtjeve qe lidhen me vijimesine dhe perdorimin e bazes se vijimesise te kontabilitetit, perveç rasteve kur drejtimi synon te likuidoje Shoqerine ose te pushoje veprimtarine, ose nuk ka asnje alternative tjeter realiste perveç kesaj.

Ata qe jane te ngarkuar me qeverisjen jane pergjegjes per mbikeqyrjen e procesit te raportimit financiar te Shoqerise.

Pergjegjesite e Audituesve per Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë qe te arrijme siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare ne tërësi nuk kane anomali materiale, per shkak te mashtrimit apo gabimit, dhe qe te lëshojmë nje raport auditimi qe perfshin opinionin tone. Siguri e arsyeshme eshte nje siguri e nivelit te larte, por nuk eshte nje garanci qe nje auditim i kryer ne perputhje me SNA gjithmone do te identifikoje nje anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomalite mund te vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te marra se bashku, pritet qe ne nje menyre te arsyeshme te influencojne vendimet ekonomike te përdoruesve, te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Si pjese e nje auditimi ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNA), ne ushtrojme gjykim profesional dhe ruajme skepticizmin profesional gjate auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojme dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale te pasqyrave financiare, qofte per shkak te mashtrimit apo pasaktesive, planifikojme dhe kryejmë procedurat e auditimit, qe u pergjigjen ketyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, qe jane te mjaftueshme dhe te përshtatshme per bazat e opinionin tone. Rreziku i mos zbulimit te nje anomalie materiale, qe vjen nga mashtrimi eshte me i larte se ai qe vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund te perfshije marreveshje te fshehta, falsifikime, përjashtime te qëllimshme, informacione te deformuara, apo anashkalime te kontrollit te brendshem.

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

- Sigurojme nje njohje te kontrollit te brendshëm qe ka te beje me auditimin me qellim hartimin e procedurave te auditimit, qe jane te përshtatshme sipas rrethanave, por jo per qellim te shprehjes se nje opinioni mbi efikasitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise.
- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e vlerësimeve kontabel dhe shenimeve shpjeguese te bera nga drejtimi.
- Nxjerrim perfundime mbi pershtatshmerine e perdorimit nga drejtimi te parimit te vijimesise ne kontabilitet dhe, duke u bazuar ne evidencen e marre gjate auditimit, nese nje pasiguri materiale ekziston ne lidhje me ngjarjet ose rrethanat qe mund te hedhin dyshime domethenese mbi aftesine e njesise ekonomike per te vazhduar ne kushtet e vijimesise se biznesit. Nese arrijme ne perfundimin se nje pasiguri materiale ekziston, ne jemi te detyruar te tërheqim vemendjen ne raportin tone te audituesit per paraqitjen e ketij informacioni ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare ose, nese këto shënime jane te papershtatshme, per te modifikuar opinionin tone.
- Vleresojme paraqitjen e pergjithshme, strukturen dhe permbajtjen e pasqyrave financiare, perfshire informacionet shpjeguese te dhena, dhe nese pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet ne lidhje me to ne nje menyre qe arrin paraqitjen e drejte.

Ne komunikojme me ata te ngarkuar me qeverisje ne lidhje me, midis çeshtjeve te tjera, qellimin e planifikuar dhe kohen e auditimit dhe gjetjet e rendesishme te auditimit, duke perfshire çdo mangesi te rendesishme ne kontrollin e brendshem qe kemi identifikuar gjate auditimit tone.

Midis çeshtjeve qe ne komunikojme me ata te ngarkuar me qeverisjen, ne percaktojme, nese ka, ato çeshtje qe kane qene me te rëndësishmet per auditimin e pasqyrave financiare te periudhes aktuale dhe rrjedhimisht janë çeshtje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë këto çeshtje ne raportin tone te auditimit perveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojne paraqitjen publike te çeshtjes ose kur, ne raste shume te rralla, ne vendosim qe nje çeshtje nuk duhet komunikuar ne raportin tone te auditimit sepse ndikimi negativ qe do kishte, do te tejkalonte mjaftueshëm perfitimet e interesit publik te ketij komunikimi.

Nexia AL

Orjana Kalaja
Auditues Ligjor

Nexia AL
K91701010Q

Tirane, Shqiperi
28 qershor 2022

Top Channel sha

(të gjitha vlerat në Lek, përvec nëse nuk shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2021

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale	5	1,608,075,985	1,634,318,178
Aktivet afatgjata jomateriale	6	419,930	595,153
Llogari të arkëtueshme të tjera	7	3,965,812	4,050,190
Totali i aktiveve afatgjata		**1,612,461,727**	**1,638,963,521**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	8	2,007,063	514,085
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	572,973,047	754,225,307
Llogari të arkëtueshme të tjera	7	2,436,140	2,006,346
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	10	91,757,505	79,212,395
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	56,647,243	112,730,380
Totali i aktiveve afatshkurtra		**725,820,998**	**948,688,513**
Totali i aktiveve		**2,338,282,725**	**2,587,652,034**
KAPITALI	**12**		
Kapitali aksionar/themeltar		1,035,400,000	1,035,400,000
Rezerva të tjera		149,405,959	952,766
Rezerva ligjore		27,674,037	19,860,711
Rezerva perkthimi		1,076,998	1,016,457
Fitimi i ushtrimit		168,819,575	156,266,519
Totali i kapitalit		**1,382,376,569**	**1,213,496,453**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	13	90,116,472	26,417,276
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	14	8,002,913	13,850,201
Detyrime të tjera afatgjata	15	-	29,484,847
Totali i detyrimeve afatgjata		**98,119,385**	**69,752,324**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	148,700,515	208,981,914
Llogari të pagueshme tregtare	16	374,885,713	701,853,643
Parapagimet e arkëtuara	17	167,981,948	228,750,955
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	14	275,042	289,157
Llogari të pagueshme të tjera	18	165,943,553	164,527,588
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**857,786,771**	**1,304,403,257**
Totali i detyrimeve		**955,906,156**	**1,374,155,581**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**2,338,282,725**	**2,587,652,034**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 -31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Top Channel sha

(të gjitha vlerat në Lek, përvec nëse nuk shprehet ndryshe)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	1,557,094,507	1,340,242,584
Të ardhura të tjera	20	30,542,152	28,428,538
Total të ardhura		**1,587,636,659**	**1,368,671,122**
Materiale dhe shërbime	21	(408,505,879)	(381,796,099)
Shpenzime personeli	22	(750,513,940)	(587,898,117)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	23	(186,713,841)	(173,779,801)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(25,155,175)	(23,911,568)
Total shpenzime		**(1,370,888,835)**	**(1,167,385,585)**
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	25	(8,926,082)	(10,370,622)
Te ardhura të tjera financiare (neto)	26	(2,962,697)	(4,475,159)
Fitimi/humbja para tatimit		**204,859,045**	**186,439,756**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		**(36,039,470)**	**(30,173,237)**
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(36,039,470)	(30,173,237)
Zbritje tatim fitimi		-	-
Fitimi/humbja e vitit	27	**168,819,575**	**156,266,519**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		**60,542**	**1,985**
Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		60,542	1,985
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		**60,542**	**1,985**
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		**168,880,117**	**156,268,504**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(të gjitha vlerat në Lek, përvec nëse nuk shprehet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Perkthimi	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	**525,400,000**	**1,014,472**	**10,824,264**	**339,260,280**	**180,728,933**	**1,057,227,949**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitim i vitit	-	-	-	-	156,266,519	156,266,519
Total të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	1,985	-	-	-	1,985
Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per vitin	**-**	**1,985**	**-**	**-**	**156,266,519**	**156,268,504**
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike te njohura direkt në kapital:						
Rritje kapitali 2020	510,000,000	-	-	(510,000,000)	-	-
Transferim I fitimit te akumuluar	-	-	9,036,447	171,692,486	(180,728,933)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	**510,000,000**	**-**	**9,036,447**	**(338,307,514)**	**(180,728,933)**	**-**
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	**1,035,400,000**	**1,016,457**	**19,860,711**	**952,766**	**156,266,519**	**1,213,496,453**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitim i vitit	-	-	-	-	168,819,575	168,819,575
Total të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	60,542	-	-	-	60,542
Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per vitin	**-**	**60,542**	**-**	**-**	**168,819,575**	**168,880,117**
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Transferim I fitimit te vitit 2020	-	-	-	-	-	-
Transferim I fitimit te akumuluar	-	-	7,813,326	148,453,193	(156,266,519)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	**-**	**-**	**7,813,326**	**148,453,193**	**(156,266,519)**	**-**
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	**1,035,400,000**	**1,076,999**	**27,674,037**	**149,405,959**	**168,819,575**	**1,382,376,570**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 – 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.
Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori i Top Channel sh.a më 28 qershor 2022 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Mazars Shpk

MAZARS shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build., No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

Vjollca Hoxha

Z. Vjollca HOXHA
Drejtoreshë e Përgjithshme

TOP CHANNEL
K120070020

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		204,859,045	186,439,756
Amortizimi		118,162,109	168,106,565
Rimarrje amortizimi nga grantet		(5,861,403)	(289,157)
Kuota pjese per tu shperndare		68,551,732	9,626,016
Provizionim		-	(3,952,780)
Shpenzime per interesa		8,926,082	10,370,622
Diferenca perkthimi nga asetet		1,029	-
Fitimi operativ perpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		**394,638,594**	**370,301,022**
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Rënie/(rritje) në inventar		(1,492,978)	642,117
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		180,906,842	102,022,856
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		(474,635,178)	(345,666,250)
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra		(12,545,110)	1,007,676
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		**(307,766,424)**	**(241,993,601)**
Interesa të paguara		(8,806,433)	(10,381,077)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(45,881,492)	(34,739,059)
		(54,687,925)	**(45,120,136)**
Aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(91,745,721)	(27,304,318)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		**(91,745,721)**	**(27,304,318)**
Aktivitetet financuese			
Ripagim/ te hyrat neto nga huate afatgjata		63,699,196	(7,508,614)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		(60,281,399)	(50,384,373)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		**3,417,797**	**(57,892,987)**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		(56,143,679)	(2,010,020)
Mjetet monetare në fillim të periudhës		112,730,380	114,738,415
Diferenca perkthimi		60,542	1,985
Mjetet monetare në fund të periudhës	12	**56,647,243**	**112,730,380**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 – 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Top Channel sh.a. ("Shoqëria") është një kompani aksionere, e cila është krijuar në vitin 2001 me vendim gjykate Nr. 25561 datë 29.03.2001. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatese te ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtaret dhe Shoqërite tregtare" dhe nga statuti i saj. Adresa e selisë së shoqerisë është Rruga 17 Nentori, Godina nr.2 Kashar.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie eshte në fushen e veprimtarisë televizive kombëtare që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve te informacionit të çdo lloji me anë te zërit dhe figurës, sinjaleve te koduara, dhe shkrimit te destinuara per publikun.

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me dispozitat e ligjit Nr. 8410, datë 30.9.1998 PËR RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

Perfaqësues Ligjor i shoqerisë Top Channel sh.a është znj.Vjollca Hoxha. Shoqëria më 31 dhjetor 2021 kishte 443 punonjës të regjistruar (31 dhjetor 2020: 437).

Struktura e aksionerëve të shoqërisë si më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	**31 dhjetor 2020**
	%	**%**
Vjollca Hoxha	20%	20%
Lorela Hoxha	20%	20%
Itan Hoxha	20%	20%
Sara Hoxha	20%	20%
Redia Hoxha	20%	20%
Total	**100%**	**100%**

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e reja dhe ato te ndryshuara efektive per periudhat vjetore duke filluar me ose pas dates 1 Janar 2021 dhe qe nuk kane ndonje efekt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise:

a. Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 (Ndryshimet në SNK 16);
b. Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16)
c. Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuara

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2021:

- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 pas 30 qershor 2021 (Ndryshimet në SNK 16)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Aktivet afatagjata materiale: Shitjet perpara perdorimit (Perditesime te SNK 16);
- Referenca ne Kuadrin Konceptual (Perditesime te SNRF 3);
- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)
- Perditesime te Referencimeve ne Kuadrin Konceptual te standardeve SNRF 1 dhe deklarata e praktikave te SRNF2;
- Kontrata me kushte - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)Perkufizimi i vleresimeve kontabel (Perditesime te SNK 8);
- Tatimi i shtyre qe lidhet me Aktivet dhe Detyrimet qe vijne si pasoje e nje Transaksioni te Vetem (Perditesime te SNK 12).

3. Bazat e pergatitjes

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

3.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto paqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

3.5.1. *Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijmësisë*

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 dhe masat e miratuara nga qeveria e Shqipërisë për të zbutur përhapjen e pandemisë kanë ndikuar në Shoqërinë. Kjo ka ndikuar në performancën financiare të Shoqërisë për vitin dhe gjithashtu pozicionin e saj të likuiditetit.

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, Shoqëria njohu një fitim neto prej 168,819,575 Lek (31 Dhjetor 2020: 156,266,519 Lek).

Bazuar në pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, si dhe në pasigurinë që rrethon vazhdimësinë e ardhshme të shpërthimit pandemik, drejtimi vlerëson se nuk ka nevojë për financim shtesë për të përmbushur detyrimet e saj financiare.

Kufizimet dhe rregulloret e COVID-19 kanë ndryshuar gjatë gjithë periudhës bazuar në përhapjen e virusit në Shqipëri. Që nga data e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, është e vështirë të vlerësosh kufizimet e mundshme që do të zbatohen në Shqipëri, dhe si rezultat, është e vështirë të përgatitësh një gamë të mundshme skenarësh për çdo ndikim të mundshëm në operacionet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Megjithëse, ka ende paqartësi se si zhvillimi i ardhshëm i shpërthimit pandemik do të ndikojë Shoqërinë, Drejtimi ka një besim të arsyeshëm se ajo ka burime të përshtatshme për ti përballuar.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

3.5.2 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3. Bazat e pergatitjes (vazhdim)

3.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

3.5.3 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3.5.4 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera , me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit , bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe ne llogaritjen e vlerës neto të realizueshme . Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto , ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar . Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

4. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/LEK	120.76	123.70
USD/LEK	106.54	100.84
CHF/LEK	116.82	114.46
GBP/LEK	143.95	137.93

4.2. Instrumentat financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Per llogarite e pagueshme ,te pa paguara dhe te pa kërkuara per me shume se pese vjet per te cilat shoqeria bazuar ne te dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri per shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e me sipërme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si të ardhura te vitit qe vijne nga fshirja e tyre.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.
Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit për vitin 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	-	-
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime Teknike	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)

iii. Amortizimi (vazhdim)

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim. Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

- Eshtë e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.
- Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.
- Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivet jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

4.6. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.
Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.7. Të ardhurat

